

“Horizonti i Ri” përfundoi realizimin e projektit “Sfidat e identitetit kombëtar tek të rinjtë shqiptarë në Malin e Zi”

Edukim i gjimnazistëve për çështjet e identitetit



Projekti ka synuar të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë komunikuese, debatuese dhe prezantuese të të rinjve lidhur me çështjet e identitetit, por njëkohësisht të përgatisë edhe një gjeneratë të re të politikëbërësve shqiptarë në Malin e Zi, duke u krijuar mundësi të përfshirjes së tyre në proceset aktuale shoqërore

Ulqin - Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” ka përfunduar realizimin e projektit “Sfidat e identitetit kombëtar tek të rinjtë shqiptarë në Malin e Zi”, të mbështetur nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave në Malin e Zi.

Gjatë katër muajve, një grup i përzgjedhur i të rinjve nga të dy shkollat e mesme në Ulqin ndoqën një program të veçantë edukativ mbi çështjet e identitetit. Në kuadër të këtij programi, gjimnazistët patën mundësi që në mënyra krejtësisht inovative dhe kreative të mësojnë dhe të debatojnë për konceptin e identitetit, paragjykimet, kontekstin e identitetit në proceset e reja shoqërore dhe integruese, për mekanizmat e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave etj.

Panelet edukative me të rinj janë moderuar nga trajnerja profesioniste për punë me të rinj, Sabra Deceviq, ndërsa të ftuar të veçantë në këtë program, në cilësinë e ligjëruesve, kanë qenë edhe deputetët në Kuvendin e Malit të Zi, Genci Nimanbegu, njëherësh kryetar i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Malin e Zi, dhe Dritan Abazoviq.

Aktiviteti i fundit i realizuar në kuadër të këtij projekti ka qenë udhëtimi studimor në qytetin historik të Krujës, ku të rinjtë nga Ulqini vizituan monumentet unike të kulturës dhe historisë kombëtare shqiptare: Muzeun Kombëtar të Skënderbeut, Hyrjen kryesore në Kalanë e Krujës, Kullën e sahatit, sistemin e fortifikimit të burimeve të ujit, Hamamin, Pusin e Skënderbeut, Ullirin e Skënderbeut dhe pika tjera të

rëndësishme të këtij qyteti.

Në këtë vizitë morën pjesë edhe drejtuesit dhe zyrtarët e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave si dhe përfaqësues të Komunitetit të Ulqinit.

Në fund të kësaj vizite, pjesëmarrësve të programit iu ndanë diploma për ndjekjen e suksesshme të të gjitha aktiviteteve të projektit.

Projekti “Sfidat e identitetit kombëtar tek të rinjtë shqiptarë në Malin e Zi” ka synuar të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre komunikuese, debatuese dhe prezantuese lidhur me çështjet e identitetit, por njëkohësisht të përgatisë edhe një gjeneratë të re të politikëbërësve shqiptarë në Malin e Zi, duke u krijuar mundësi të përfshirjes së tyre në proceset aktuale shoqërore.

(Kohapress)